

# FONDACIONI “FAIK KONICA”



*Adresa:* “Abdi Kazani” pranë Liceut Artistik, Tiranë  
*Tel:* +355 68 90 97 242  
*Web:* info@faikkonica.edu.al

---

## Kodi i Etikes

Kodi i Etikës është një deklaratë publike e standarteve të sjelljes dhe ndershmërisë, e cila duhet të ndiqet nga punonjësit e Fondacionit “Faik Konica”. Ai ka për qëllim të vendosë rregullat e sjelljes së punonjësve të Fondacionit, sipas standarteve të kërkuara dhe t’i ndihmojë ata për arritjen e këtyre standarteve. Në kryerjen e funksioneve të tyre punonjësit e Fondacionit duhet të respektojnë parimet si më poshtë:

### 1. Respekt për Ligjin dhe Sistemin drejtues

Punonjësit e Fondacionit “Faik Konica” si të gjithë qytetarët e tjerë kanë detyrim që të zbatojnë ligjet e vendit, dhe kur janë jashtë shtetit të zbatojnë ligjet dhe zakonet e vendit pritës. Punonjësit duhet të respektojnë Statutin dhe Politikat e Fondacionit.

### 2. Respekt për Njerëzit

Nga Stafi i Fondacionit “Faik Konica” kërkohet trajtimi i studentëve, punonjesve, dhe anëtarëve të komunitetit në mënyrë të barabartë dhe me respekt.

- Mirësjellje, kortezi dhe përgjegjësi në marrëdhënie me të tjerët;
- Shmangie e veprimeve në dëm të një personi apo të Fondacionit dhe të tregohet respekti i duhur për të drejtat dhe interesat personale të të tretëve;
- Marrje e vendimeve që janë proceduralisht të drejta ndaj njerëzve;
- Shmangie e diskriminimit mbi baza të tilla si: gjini, race, orientimi seksual, orientimi fetar, gjendje civile, moshe ose bindje politike;
- Respekt ndaj shprehjes së këndvështrimeve dhe opinioneve të të tjerëve;
- Shmangie të sjelljeve të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të shihen si ngacmim, kërcënim ose frikësim;

### 3. Drejtesi

Në bashkëpunimin tonë me të tjerët, në përpiqemi që të jemi të drejtë në vendimet dhe veprimet tona.

- I gjithë procesi i punësimit dhe ngritjes në përgjegjësi të kryhet sipas një procedure të drejtë;
- Shpërndarja e punës të kryhet në mënyrë të barabartë;
- Vlerësimi i studentëve të jetë objektiv;
- Të sigurohet mbështetja e duhur ndaj stafit dhe studentëve;

### 3.1 Garantimi i të dhënave Personale

Garantimi i të dhënave personale ne Fondacionin tonë bëhet në bazë të Ligjit nr.9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Kjo do të thotë se të dhënat e mbajtura për studentin:

- a) Përdoren vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunimi të bëhet në përputhje me këto qëllime;
- b) Të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- c) Të saktësohen nga ana faktike dhe kur është e nevojshme, të bëhet përditësimi e kryerja e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen si edhe të dhënat nuk do të mbahen më shumë se është e nevojshme;
- ç) Të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej;
- d) Çdo përpunim duhet të jetë i sigurtë
- ç) I gjithë procesi i përpunimit duhet të bëhet në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale;

### 4. Ndershmëri

Në kryerjen e detyrave të tyre punonjësit duhet të jenë të ndershëm, të paanshëm dhe efikas duke pasur parasysh vetëm interesat e Fondacionit.

- Të mos lejohet që interesat private të bien ndesh me pozicionin e punës;
- Të shmangen konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzohet asnjëherë pozita për interes privat;
- Të ruhet konfidencialiteti i informacionit të marrë gjatë detyrave të punës;
- Të veprohet në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe të mos pengohet zbatimi i politikave dhe vendimeve zyrtare;

### 5. Veprimtarite e jashtme

Punonjësi i Fondacionit nuk duhet të angazhohet në një veprimtari të jashtme e cila pengon kryerjen e detyrave të tij, apo që kërkon një angazhim mendor apo fizik e cila e bën të vështirë kryerjen e detyrës së tij në Fondacion.

- Kryerja e veprimtarive të jashtme duhet t’i njoftohet paraprakisht drejtuesit të njesise dhe zyres se personelit;
- Drejtori i njesise percakton rregullat e klasifikimit të një veprimtarie të jashtme si e lejueshme apo jo;

## **6. Detyrimet e punonjesve dhe nxenesve**

Punonjesit e Fondacionit nuk duhet ta perdorin pozicionin e punes per te patur ndonje perfitim financiar ose te ndonje lloji tjetere me interes personal.

- Punonjesit duhet të përdorin burimet e Fondacionit vetëm për realizimin e detyrave të tyre dhe jo për qëllime personale.
- Punonjesit duhet ta mbrojnë dhe ruajnë pronën e Fondacionit, përfshirë këtu edhe dokumentacionin zyrtar;
- Punonjesit duhet ta përdorin kohën e punës në mënyrë efektive për realizimin e detyrave të punës;
- Pas largimit nga detyra, punonjesit nuk duhet ta përdorin informacionin konfidencial të marrë gjatë kryerjes së detyrës, për interes personal;
- Veshja dhe paraqitja e punonjesve dhe nxenesve duhet të jetë serioze, për ta përfaqësuar sa më denjësisht fondacionin arsimor, pa prezantime ekstreme të modes, besimeve fetare, apo rrymave të ndryshme;
- Nuk duhet të konsumohet alkool apo të pihet duhan në ambientet e Fondacionit Faik Konica;
- Nuk lejohet sjellja e armëve në Fondacion.